



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE
PËR STUDENTËT NDËRKOMBËTARË
TË UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI” TË VLORËS

**Miraturar me Vendim Nr. 89 të Senatit Akademik të Universitetit ‘Ismail Qemali’,
datë 22.09.2025**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

Preambula

Kjo rregullore e brendshme përcakton kuadrin, procedurat, të drejtat dhe detyrimet që rregullojnë statusin dhe veprimtarinë e studentëve ndërkombëtarë në Universitetin e Vlorës. Fokusi i kësaj rregullore është të garantojë një proces pranimi transparent dhe efikas, të lehtësojë integrimin akademik dhe social, të sigurojë pajtueshmërinë me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe të ofrojë kushte për një jetë studentore cilësore. Dispozitat e këtij akti janë në përputhje me legjislacionin kombëtar, si edhe me standardet dhe praktikatat më të mira të njohura ndërkombëtarisht në arsimin e lartë.

Shkurtime:

UV – Universiteti ‘Ismael Qemali’, Vlorë.

QSHA – Qendra e Shërbimeve Arsimore pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.

IAL – Institucion i Arsimit të Lartë

SA – Senati Akademik i Universitetit ‘Ismael Qemali’, Vlorë.

BA – Bordi i Administrimit i Universitetit ‘Ismael Qemali’, Vlorë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë dhe të rregullojë procedurat e pranimit, regjistrimit dhe ndjekjes së progresit akademik të studentëve ndërkombëtarë në Universitetin e Vlorës.
2. Kjo rregullore gjithashtu synon të sanksionojë të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë gjithë periudhës së studimeve, duke garantuar transparencë institucionale, barazi trajtimi dhe efikasitet operativ në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen për të gjithë studentët ndërkombëtarë të regjistruar në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor), ciklit të dytë (Master) dhe ciklit të tretë (Doktoraturë), shkollën verore, mini-kurset, aktivitetet Life Long Learning dhe çdo veprimtari tjetër akademike në Universitetin e Vlorës.
2. Kjo rregullore është e detyrueshme për të gjitha njësitë akademike dhe administrative të Universitetit që lidhen me pranimin, regjistrimin, ndjekjen e studimeve dhe mbështetjen institucionale të studentëve ndërkombëtarë.
3. Dispozitat e kësaj rregullore nuk zbatohen për studentët e huaj pjesëmarrës në programe shkëmbimi afatshkurtër, mobilitete semestrale, apo programe të ngjashme të bashkëpunimit ndërkombëtar, e cila rregullohet me rregullore të veçantë.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto përkufizime:

“Student ndërkombëtar” – çdo shtetas joshqiptar, i cili ka përfunduar një diplomë pararendëse jashtë sistemit arsimor të Republikës së Shqipërisë dhe është i regjistruar në një **“Saktori i Marrdhënieve me Jashtë”** – njësia strukturore përgjegjëse për zbatimin e politikave të bashkëpunimit ndërkombëtar.

“Saktori i Karrierës, Shërbimit të Studentëve dhe Alumnit” – njësia strukturore përgjegjëse për koordinimin, ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjen e studentëve ndërkombëtarë.

“Pranimi” – vendimi zyrtar i Universitetit për të pranuar një kandidat ndërkombëtar në një program studimi, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në Rregullore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE SENATI AKADEMIK

“Regjistrimi” – veprimi zyrtar i pajisjes së studentit me statusin e studentit aktiv në Universitet, përfshirë dorëzimin e dokumenteve, pagesën e tarifave dhe konfirmimin e pjesëmarrjes në programin studimor.

“Program studimi” – cikli i plotë i studimeve (Bachelor, Master, Doktoraturë) i organizuar nga Universiteti, me plan mësimor të miratuar dhe kredite akademike të përcaktuara.

“Progresi akademik” – ndjekja dhe përmbushja e detyrimeve akademike sipas planit mësimor, duke përfshirë pjesëmarrjen në lëndë, provime dhe aktivitete të tjera të përcaktuara nga Fakulteti.

“Tarifat e shkollimit” – pagesat që studentët ndërkombëtarë janë të detyruar t’i kryejnë për pjesëmarrje në programet e studimit, sipas përcaktimeve të Rregullores dhe njoftimeve zyrtare.

“Bursa dhe mbështetje financiare” – çdo formë ndihme financiare e ofruar nga Universiteti, bazuar në meritë, nevojë ose kriter të veçantë, përfshirë procedurat e aplikimit të përcaktuara nga Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

“Viza studentore” – dokument ligjor që lejon studentin ndërkombëtar të hyjw dhe studiojë në Republikën e Shqipërisë.

“Leje qëndrimi” – dokument ligjor i nevojshëm për të mbajtur statusin e studentit në Shqipëri dhe për të ushtruar të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara nga kjo Rregullore.

“Strehimi universitar” – vendi i caktuar nga Universiteti ku studentët mund të qëndrojnë gjatë studimeve, duke respektuar rregulloret e qëndrimit.

“Shërbime studentore / Shërbime mbështetëse” – të gjitha shërbimet akademike, administrative, sociale dhe këshilluese të ofruara nga Universiteti, përfshirë bibliotekat, laboratorët, ambientet sportive dhe shërbimet mjekësore.

“Integritet akademik” – respektimi i ndershmërisë akademike, shmangia e plagjiaturës dhe ndjekja e rregullave të provimit dhe të tjera të përcaktuara nga Universiteti.

“Shkelje disiplinore” – çdo veprim ose mosveprim i studentit që shkel rregulloret akademike ose universitare dhe që mund të rezultojë në paralajmërime, pezullim ose përjashtim sipas procedurave disiplinore.

“Diplomimi dhe certifikimi” – procesi dhe dokumentet që konfirmojnë përfundimin e suksesshëm të programit studimor, përfshirë diplomën dhe transkriptin e notave, si dhe çdo dokument tjetër të njohur zyrtarisht nga Universiteti dhe autoritetet shqiptare.

“Mobilitet studentor” – pjesëmarrja e studentit në programe shkëmbimi, semestra të jashtme, trajnime ose praktikë jashtë Universitetit, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe rregulloreve specifike të mobilitetit.

“Vetdeklarimi i akomodimit” – dokumenti i lëshuar nga studentët ndërkombëtarë për të konfirmuar vendbanimin e tyre gjatë studimeve, sipas procedurave të Universitetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

KAPITULLI II

PRANIMI DHE PRANUESHMËRIA

Neni 4

Kërkesat e Pranimit

1. Kandidatët ndërkombëtarë duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm ose të lartë, me diploma të njohura dhe ekuivalente me sistemin arsimor të Republikës së Shqipërisë.
2. Kandidatët duhet të disponojnë vërtetim të aftësisë gjuhësore, në gjuhën shqipe ose angleze/gjuhë të tjera të BE, sipas kërkesave të programit të studimit.
3. Aftësitë gjuhësore në gjuhën angleze/gjuhë të tjera të BE duhet të jenë të vërtetuara me çertifikata të fituara nga testet ndërkombëtare, sipas udhëzimit të ministrisë përkatëse të arsimit.
4. Aftësitë gjuhësore në gjuhën shqipe duhet të jenë të vërtetuara me çertifikata të lëshuara nga UV. Në rastin e çertifikatave gjuhësore të lëshuara nga IAL e tjera shqip-folëse, UV rezervon të drejtën e zhvillimit të një provimi testues përpara pranimit në programin e studimit.
5. Kandidatët që nuk zotërojnë aftësi gjuhësore në gjuhën shqipe, por synojnë të ndjekin programe studimi në gjuhën shqipe mund të ndjekin paraprakisht mini-kurse përgatitore për mësimin e gjuhës shqipe në UV.
6. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumente të vlefshme identifikimi dhe dokumente akademike që konfirmojnë përfundimin e arsimit pararendës, të njehsuara ose në proces njehsimi nga ministria përkatëse për arsimin.
7. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret specifike të programit, të përcaktuara nga fakultetet përkatëse, duke përfshirë kriteret akademike, gjuhësore ose të tjera të veçanta.
8. Dokumentet që duhet të dorëzohen bashkë me aplikimin përfshijnë:
 - a) Formularin e aplikimit sipas Shtojcës bashkëlidhur të kësaj Rregulloreje (Annex1).
 - b) Kopjen e dokumentit të lëshuar nga QSHA që çertifikon njohjen e diplomës së arsimit të mesëm të lartë, të shoqëruar me kopje të diplomës dhe transkriptit të notave. Kandidatët që nuk kanë përfunduar procesin e njohjes dhe barazimit duhet të dorëzojnë provë se kanë aplikuar në QSHA për njohje dhe barazim.
 - c) Kopjen e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose letërnjoftim).
 - d) Vërtetimin e njohurisë së gjuhës shqipe, sipas pikës 4 të këtij neni (vetëm për programet që zhvillohen në gjuhën shqipe). Kjo nuk aplikohet për studentët e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë.
 - e) Dy fotografi personale.
 - f) Kopjen e dëshmisë së pagesës së tarifës së aplikimit.
9. Studentët ndërkombëtarë që aplikojnë për programet e studimit të ofruara në gjuhën angleze duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:
 - a) Formularin e aplikimit sipas Shtojcës Nr. 1.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SENATI AKADEMIK

- b) Kopje të diplomës së arsimit të mesëm dhe transkriptin e notave, të legalizuar/apostiluar dhe të përkthyer zyrtarisht në gjuhën shqipe ose angleze, për programet e ciklit të parë (Bachelor).
- c) Kopje të diplomës së ciklit të parë (Bachelor) dhe transkriptin e notave, të legalizuar/apostiluar dhe të përkthyer zyrtarisht në gjuhën shqipe ose angleze, për programet e ciklit të dytë (Master).
- d) Kopje të pasaportës (e vlefshme) dhe dy (2) fotografi pasaporte.
- e) Dëshmi të pagesës së tarifës së aplikimit (faturë ose kupon bankar, sipas Shtojcës Nr. 2).
- f) Çertifikatë të njohurive të gjuhës angleze (TOEFL, IELTS ose ekuivalent), ku aplikohet, ose çdo provë tjetër të aftësisë gjuhësore sipas kërkesave të programit të studimit.

Neni 5

Procedurat e Aplikimit

1. Aplikimet për të gjithë studentët ndërkombëtarë mund të dorëzohen:
 - a) personalisht - në sekretariatet akademike të njësive kryesore të fakulteteve;
 - b) online - për programet që ofrohen në gjuhën angleze, aplikimet mund të dërgohen
 - me email në adresën apply@univlora.edu.al,
 - website e UVduke përdorur formularin e aplikimit sipas Shtojcës Nr. 1.
2. Afatet dhe formularët e aplikimit publikohen çdo vit në faqen zyrtare të internetit të Universitetit të Vlorës, si dhe në njësitë akademike dhe Sektorin e Marrdhënieve me Jashtë.
3. Kandidatët për programet në gjuhën angleze duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentet e kërkuara sipas Neni 4, paragrafi përkatës për programet në anglisht, përfshirë: formularin e aplikimit, kopjet e diplomave dhe transkripteve të noterizuara dhe të përkthyer, pasaportën, fotografitë personale, dëshminë e pagesës dhe çertifikatën e njohurive të gjuhës angleze (TOEFL, IELTS ose ekuivalent).
4. Paga e Tarifës së Aplikimit:

Tarifa e aplikimit për programet ndërkombëtare kryhet në një nga mënyrat e mëposhtme:

 - a) Nëpërmjet posteve ose bankave të nivelit të dytë, në llogarinë e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
 - b) Nëpërmjet transferitës bankare në llogarinë e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.Paga duhet të bëhet sipas modelit të faturës të dhënë në Shtojcën Nr. 2.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 6

Përzgjedhja e kandidatëve fitues

1. Përzgjedhja e kandidatëve ndërkombëtarë fitues për ndjekjen e studimeve në UV bëhet në dy faza:
 - a. Verifikimi i autenticitetit të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikantët.
 - b. Përzgjedhja e kandidatëve fitues.
2. Verifikimi i autenticitetit të dokumentacionit të dorëzuar bëhet nga Komisioni i Verifikimit të Dokumentacionit Ndërkombëtar, i ngritur në nivel institucional prej Rektorit të UV, me përbërje si më poshtë:
 - a. zv.rektori akademik – kryetar komisioni
 - b. përfaqësues i Sektorit të kurrikulës dhe Statistikave – sekretar komisioni.
 - c. përfaqësues i Sektorit të Marrdhënieve me Jashtë – anëtar komisioni.
 - d. përfaqësues i Sektorit të Këshillimit, Shërbimit të Studentëve dhe Alumnit – anëtar komisioni.
 - e. përfaqësues i Sektorit Juridik – anëtar komisioni.
3. Ky komision merr në vlerësim gjithë dokumentacionet e dorëzuara nga aplikime në formë shkresore dhe elektronike. Për vlerësimin e autenticitetit të tyre, komisioni mund të drejtohet edhe institucioneve përgjegjëse jashtë UV.
4. Në rast të konstatimit të mangësive në dokumente, apo nevojës për dokumenta shtesë provues, komisioni kontakton kandidatin me kërkesën për plotësim dokumentacioni.
5. Dosjet e vlerësuara si autentike dhe konform procedurave të kërkuara, u përcillen njësive kryesore bazë për vazhdimin e procedurave të mëtejshme.
6. Komisioni i Përzgjedhjes së Studentëve Ndërkombëtarë ngrihet në bazë departamenti, i propozuar prej drejtuesit të njësisë bazë dhe i miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore.
7. Komisioni i Përzgjedhjes së Studentëve Ndërkombëtarë pasi merr në dorëzim dosjet e kandidatëve, të vërtetuara si autentike prej Komisionit të Verifikimit të Dokumentacionit Ndërkombëtar, liston kandidatët sipas kriterëve të përcaktuara paraprakisht nga departamenti, që ofron këtë program.
8. Listimi dhe përzgjedhja e kandidatëve bëhet në bazë të:
 - a. Kriterëve të pranimit në programin e studimit, për studentë ndërkombëtarë.
 - b. Meritave akademike dhe rezultateve të studimeve pararendëse;
 - c. Aftësive gjuhësore të kërkuara nga programi;
 - d. Kapacitetit të programit dhe vendeve të disponueshme
9. Vendimi i komisionit i përcillet rektorit të UV, i cili pasi verifikon zbatimin korrekt të procedurës së përzgjedhjes nëpërmjet Zv.rektorit akademik, e përcjell listën fituese tek njësitë kryesore për vazhdimin e procedurave të mëtejshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 7

Publikimi i rezultateve dhe regjistrimi i kandidatëve

1. Lista përfundimtare e kandidatëve të pranuar, e identifikuar me ID-në e Kandidatit, do të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit (www.univlora.edu.al) dhe në ambiente të Universitetit, në përputhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Në rast të aplikimeve online njoftimi, për pranimin ose jo në programet akademike të UV, mund të dërgohet edhe në adresat elektronike të kandidatëve nëpërmjet personelit ndihmës-akademik që administron adresat elektronike të aplikimeve.
3. Kandidatët mund të regjistrohen vetëm në një nga programet e studimit në të cilin janë shpallur të pranuar.

Neni 8

Procesi i Regjistrimit

1. Kandidati që shpallet fitues në ciklin e parë, të dytë, ose të tretë, ka të drejtë të ndjekë studimet në vitin e parë akademik në programin e studimit të kërkuar, nëse regjistrohet në sekretarinë mësimore të fakultetit dhe paguan tarifën e shkollimit sipas afateve; në të kundërt ai humbet përfundimisht të drejtën e regjistrimit.
2. Kandidati, që e ka njehsuar dokumentacionin shkollor në QSHA, fiton statusin e studentit pasi është regjistruar në sekretarinë mësimore, ka plotësuar të gjitha detyrimet dhe zotëron vërtetimin e regjistrimit.
3. Kandidati, që është në proces njehsimi të dokumentacionit shkollor në QSHA, regjistrohet si 'student me rezervë' dhe fiton statusin e studentit vetëm pasi i vjen dokumentacioni shkollor i njehsuar dhe matrikullimi nga QSHA.
4. Studentët regjistrohen në lëndët përkatëse çdo semestër, sipas udhëzimeve të fakultetit dhe planifikimit të lëndëve semestrale, duke respektuar afatet dhe procedurat e përcaktuara nga UV.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

KAPITULLI III

TARIFAT E SHKOLLIMIT DHE DETYRIMET FINANCIARE

Neni 9

Tarifat e Shkollimit

1. Në fillim të çdo viti akademik, studenti është i detyruar të regjistrohet në sekretarinë mësimore të fakultetit për vitin në vazhdim brenda muajit tetor dhe të paguaj tarifën e detyrimeve për vitin akademik.
2. Mospagimi i detyrimeve financiare e penalizon sipas rregullave të miratuara në aktet rregullatore të UV.
3. Tarifat e shkollimit publikohen çdo vit në faqen zyrtare të Universitetit.

Neni 10

Bursat dhe Mbështetja Financiare

1. Përfitojnë bursë nga fondi i mbështetjes studentore, në masën e përcaktuar në VKM nr 39, datë 23.01.2019, studentët e pranuar në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve, programet e integruara të studimeve, si dhe studentët e shtresave sociale në nevojë, që plotësojnë kriteret e listuara në VKM-në e sipërcituar.
2. Studentët aplikojnë për bursë, sipas kriterëve të përcaktuar në VKM, me dokumentacionin provues të plotësimit të kriterëve, në momentin e regjistrimit, pranë institucioneve publike të arsimit të lartë ose në momentin që plotësojnë kriteret vendimit.
3. Njësitë kryesore, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës dhe e dokumentacionit, kryejnë verifikimet e nevojshme për plotësimin e tij në bashkëpunim me institucionet të cilat kanë detyrimin ligjor për të konfirmuar dokumentacionin dhe i dërgojnë për shqyrtim dhe miratim në bordin e administrimit.
4. Bordi i Administrimit shqyrton dhe merr vendim për bursat financiare për studentët që përmbushin kriteret, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga studenti.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

KAPITULLI IV

VIZA STUDENTORE DHE LEJA E QËNDRIMIT

Neni 11

Aplikimi dhe Lëshimi i Vizës Studentore

1. Pas pranimit në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, kandidati ndërkombëtar duhet të aplikojë për vizë studentore përmes sistemit elektronik të vizave (E-Visa), dhe më pas të paraqitet personalisht në konsullatën përkatëse ose, në rast marrëveshesh bilaterale ose multilaterale, në misionet diplomatike të vendeve të përfshira.
2. Kandidati duhet të ketë pasaportë të vlefshme për të paktën 3 muaj pas skadimit të vizës për të cilën aplikohet, me të paktën dy faqe të lira për vulat e vizës.
3. Lëshimi i vizës, bëhet vetëm pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të aplikimit nga autoritetet përgjegjëse, sipas udhëzimeve të përbashkëta të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Rendit Publik dhe Drejtorisë së Shërbimit Informativ Shtetëror, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës.
4. Studentët që marrin vizë mund të hyjnë në Republikën e Shqipërisë dhe të fillojnë regjistrimin në Universitet pas konfirmimit të statusit ligjor të qëndrimit.

Neni 12

Leja e Qëndrimit për Studentët Ndërkombëtarë

1. Studentët ndërkombëtarë, që hyjnë dhe qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë për qëllime studimi në institucione arsimore publike ose private të njohura nga shteti shqiptar kanë të drejtën të aplikojnë për leje qëndrimi sipas kritereve të përgjithshme.
2. Studentëve të pranuar në Universitet u lëshohet një leje qëndrimi me vlefshmëri jo më shumë se një vit kur lëshohet për herë të parë. Leja mund të zgjatet çdo vit deri në përfundimin e studimeve, shkollës ose praktikës profesionale.
3. Dokumentacioni nga vendi i origjinës dhe/ose vendi ku studenti ka pasur qëndrim ligjor duhet të përkethehet në shqip, të verifikohet dhe të legalizohet sipas detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare.
4. Studentët duhet të vërtetojnë pranimin nga Universiteti dhe të kenë mjetet financiare të mjaftueshme për të mbuluar qëndrimin gjatë studimeve. Dëshmia e mjeteve financiare mund të jetë: certifikatë depozite bankare, fonde personale ose familjare. Për studentët ndërkombëtarë pranohen edhe burime të tjera financimi, si: grant, bursë, kontratë pune e vlefshme ose ofertë pune, me një minimum prej 300,000 ALL për person për një vit akademik.
5. Për rinovimin e lejes së qëndrimit, studenti duhet të vërtetojë progresin akademik, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Studentët duhet të aplikojnë për leje qëndrimi brenda 30 ditëve nga hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe, në rast hyrjeje pa vizë, brenda periudhës së qëndrimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

ligjor. Rinovimi i lejes duhet të bëhet brenda 60 ditëve para skadimit të lejes aktuale, duke plotësuar formularin standard dhe duke dorëzuar dokumentet e kërkuara, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave.

7. Formulari i aplikimit përmban informacion personal të studentit, shtetësinë, të dhënat e pasaportës, kualifikimet arsimore, profesionin, statusin martesor, qëllimin e qëndrimit, mjetet financiare, arsyet për qëndrimin e planifikuar, si dhe të dhënat për regjistrimin e mjeteve të transportit, nëse ka, të regjistruara jashtë Shqipërisë.
8. Autoritetet përgjegjëse për kufijtë dhe migracionin shqyrtojnë aplikimin për lëshimin ose rinovimin e lejes së qëndrimit. Në rast se dokumentacioni nuk plotëson kushtet e nevojshme, autoriteti rajonal i kufirit dhe migracionit do të njoftojë studentin për mangësitë dhe do t'i kërkojë përmbushjen e tyre brenda 30 ditëve, duke shtyrë kështu procesin e shqyrtimit dhe aprovimit.
9. Pas pranimit të aplikimit, studentit i lëshohet leje e përkohshme qëndrimi, e cila zëvendëson plotësisht vlefshmërinë e lejes së qëndrimit për të cilën është aplikuar dhe dorëzohet në momentin e marrjes së lejes përfundimtare. Format i lejes së përkohshme miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Paketa e mbështetjes së studentëve ndërkombëtarë nga UV

Universiteti 'Ismail Qemali' mund ti mbështesë kandidatët, e përzgjedhur si studentë ndërkombëtarë në programet e tij të studimit, në mënyrat e mëposhtme:

1. Asistencë në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe aplikimin për njehsimin e dokumenteve shkollë nga QSHA.
2. Asistencë për përmbushjen e procedurave të rregjistrimit në UV.
3. Tutorial individual për njohjen dhe familjarizimin me programet, website-in, sistemin informativ të brendshëm të komunikimit, si dhe ambientet universitare të UV.
4. Tutorial individual për njohjen dhe familjarizimin me ambientet akomoduese dhe qytetin e Vlorës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

KAPITULLI V
AKOMODIMI DHE SHËRBIMET

Neni 14

Burimet e të Ardhurave për Studentët Ndërkombëtarë

1. Studentët ndërkombëtarë duhet të vërtetojnë pranimin e tyre nga Universiteti ku do të ndjekin studimet dhe të kenë mjete financiare të mjaftueshme për të mbuluar qëndrimin e tyre në Republikën e Shqipërisë gjatë periudhës së studimeve.
2. Dëshmia e mjeteve financiare mund të përfshijë:
 - a) Çertifikatë depozite bankare nga një bankë e nivelit të dytë;
 - b) Fonde personale ose familjare;
 - c) Burime të tjera të pranueshme, si grant, bursë, kontratë pune e vlefshme ose ofertë pune.
3. Minimumi i mjeteve financiare duhet të jetë 300,000 ALL për person për një vit akademik (referuar legjislacionin ligjor në fuqi), për të garantuar mbulimin e shpenzimeve të jetesës.
4. Dokumentacioni i dorëzuar duhet të jetë i plotë, i vlefshëm dhe, kur është e nevojshme, i përkthyer në shqip dhe legalizuar sipas legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.
5. Autoritetet përgjegjëse mund të kërkojnë informacion shtesë ose dokumente mbështetëse për të vërtetuar mjaftueshmërinë e mjeteve financiare të studentit.

Neni 15

Shërbimet e Kampusit

1. Studentët ndërkombëtarë kanë qasje në biblioteka, laboratorë, ambiente sportive, këshillim dhe shërbime mjekësore.
2. Studentët mund të akomodohen në Konviktet e Qytezës Studentore, duke paraqitur dëshminë e regjistrimit në Universitet dhe duke shlyer tarifën përkatëse të akomodimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

KAPITULLI VI
TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 16

Të Drejtat e Studentëve Ndërkombëtarë

1. Me regjistrimin në Universitet dhe fitimin e statusit të studentit, studentit ndërkombëtar gëzon të njëjtat të drejta si studenti vendas, të parashikuara në Statut, në Rregulloren e Brendshme të Universitetit, në Rregulloren për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe në çdo akt tjetër ligjor e nënligjor që mbrojnë të drejtat e studentëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Studentët ndërkombëtarë kanë të drejtë në qasje të barabartë në arsim, në të gjitha burimet akademike, laboratorike, bibliotekare dhe teknologjike, si dhe në aktivitetet studentore dhe sportive të ofruara nga universiteti.
3. Studentët ndërkombëtarë kanë të drejtë të marrin pjesë në jetën studentore, përfshirë qeverisjen studentore, organizatat dhe shoqatat studentore, si dhe në veprimtari kulturore e shkencore të Universitetit.
4. Të dhënat personale të studentëve ndërkombëtarë mbrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e sigurisë së të dhënave.
5. Universiteti u garanton studentëve ndërkombëtarë të drejtën për informim të plotë, të qartë dhe në kohë lidhur me proceset akademike, shërbimet studentore dhe mbështetjen institucionale.
6. Studentët ndërkombëtarë gëzojnë të drejtën e aksesit në shërbime mbështetëse, duke përfshirë orientimin akademik, këshillimin psikologjik, ndihmën për çështjet e vizave dhe lejeve të qëndrimit, si dhe lehtësimin e integritetit social e kulturor.

Neni 17

Detyrimet e Studentëve Ndërkombëtarë

- a. *Pajtueshmëria institucionale.* Studentët ndërkombëtarë janë të detyruar të respektojnë Statutin, Rregulloren e Brendshme, këtë Rregullore, rregulloret e fakulteteve dhe çdo akt tjetër të brendshëm të Universitetit të Vlorës.
- b. *Pajtueshmëria me ligjin.* Respektimi i legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe standardeve të komunitetit universitar është i detyrueshëm.
- c. *Integriteti akademik.* Zbatimi i parimeve të ndershmërisë akademike dhe i rregullave të provimeve, duke shmangur çdo formë plagjiature apo mashtrimi.
- d. *Përmbushja e kërkesave akademike.* Ndjekja e programit, pjesëmarrja në mësim/laborator, përmbushja e detyrimeve të lëndëve dhe ruajtja e progresit minimal akademik sipas planeve mësimore.
- e. *Regjistrimi semestral.* Regjistrimi në lëndë çdo semestër sipas afateve dhe udhëzimeve të fakultetit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- f. *Dokumentacion i saktë.* Dorëzimi i dokumenteve të sakta, të plota dhe brenda afateve; ndalohet paraqitja e dokumenteve të rreme ose të pavlefshme.
- g. *Tarifat dhe detyrimet financiare.* Pagesa në kohë e tarifave dhe çdo detyrimi tjetër financiar ndaj Universitetit, sipas afateve dhe procedurave përkatëse .
- h. *Statusi ligjor i qëndrimit.* Mbajtja e vlefshmërisë së vizës/lejes së qëndrimit dhe pajtueshmëria me kushtet e tyre; raportimi në kohë i çdo ndryshimi të statusit ligjor, adresës apo të dhënave të kontaktit .
- i. *Mbrojtja e të dhënave.* Respektimi i rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mosshkelja e privatësisë së të tjerëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- j. *Sjellja dhe etika.* Respektimi i rregullave të sjelljes, i barazisë, mosdiskriminimit dhe i dinjitetit të anëtarëve të komunitetit universitar; ndalohet çdo formë dhune, ngacmimi apo sjellje denigruese.
- k. *Përdorimi i infrastrukturës.* Përdorimi i përgjegjshëm i bibliotekave, laboratorëve, pajisjeve dhe ambienteve universitare; ruajtja e pronës dhe kthimi i materialeve të huazuara sipas rregullave.
- l. *Akomodimi.* Respektimi i rregullave të strehimit universitar dhe të akomodimit jashtë kampusit, kur ofrohet .
- m. *Burimet IT.* Përdorimi i rrjeteve dhe burimeve TIK të Universitetit sipas politikave përkatëse; ndalimi i përdorimit të tyre për veprimtari të paligjshme ose që çënojnë sigurinë.
- n. *Identifikimi.* Mbajtja e Kartës së Studentit dhe paraqitja e saj kur kërkohet nga autoritetet e Universitetit.
- o. *Komunikimi zyrtar.* Ndjekja e komunikimeve zyrtare të Universitetit dhe përdorimi i kanaleve zyrtare të komunikimit.
- p. *Bashkëpunimi me autoritetet.* Paraqitja kur thirret nga njësitë akademike/administrative, si dhe bashkëpunimi në proceset institucionale (anketa, verifikime, procedura disiplinore).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

KAPITULLI VII
SJELLJA DHE DISIPLINA AKADEMIKE

Neni 18
Integriteti Akademik

1. Studentët ndërkombëtarë janë të detyruar të respektojnë parimet e ndershmërisë dhe të integritetit akademik, si pjesë thelbësore e procesit arsimor.
2. Studentët duhet të shmangin çdo formë plagjiature, falsifikimi, mashtrimi ose përvetësimi të punës së tjerëve, në punime, projekte, disertacione, si dhe në çdo aktivitet tjetër akademik.
3. Në procesin e provimeve dhe vlerësimeve, studentët janë të detyruar të ndjekin rregullat e përcaktuara nga Universiteti, duke përfshirë: ndalimin e përdorimit të materialeve të palejuara, ndalimin e komunikimit ose ndihmës së paligjshme, si dhe respektimin e udhëzimeve të personelit akademik.
4. Çdo punë akademike e paraqitur nga studenti duhet të jetë origjinale dhe e përgatitur në mënyrë të pavarur, përveç rasteve kur parashikohet punë në grup, sipas udhëzimeve të pedagogut.
5. Studentët janë të detyruar të zbatojnë nenet përkatëse të Rregullores së Brendshme dhe të Statutit të Universitetit, si dhe çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor që rregullon standardet e integritetit akademik.
6. Çdo shkelje e integritetit akademik përbën shkelje disiplinore dhe sjell masa ndëshkuese sipas procedurave të parashikuara në këtë Rregullore dhe në legjislacionin në fuq

Neni 19
Shkeljet dhe Masat Disiplinore

1. Shkelje të rregullave të institucionit konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit ndërkombëtar që çenojnë personalitetin dhe dinjitetin e pedagogëve, punonjësve apo studentëve të tjerë; që bien ndesh me normat etiko-morale dhe me rregulloret e Universitetit. Këtu përfshihen, por nuk kufizohen vetëm në:
 - a) mashtrimi ose kopjimi në provime dhe vlerësime;
 - b) plagjiatura dhe përdorimi i padrejtë i punimeve akademike;
 - c) falsifikimi i dokumenteve zyrtare;
 - d) sjellje të papërshtatshme që çenojnë rendin, sigurinë dhe imazhin e universitetit;
 - e) shkelje të përsëritura të rregullores së brendshme dhe Kodit të Etikës së UV-së.
2. Për shkeljet e kryera, ndaj studentit ndërkombëtar mund të merren këto masa disiplinore, të vendosura në përpjesëtim me natyrën dhe rëndësinë e shkeljes:
 - a) Vërejtje me shkrim;
 - b) Shërbime të detyruara universitare (në ambientet e universitetit)
 - c) Pezullim nga ndjekja e studimeve dhe aktiviteteve universitare për një periudhë të caktuar (deri në një vit akademik);



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- d) Përfundimtar nga Universiteti.
3. Masat disiplinore a) dhe b) të pikës 2 të këtij neni propozohen nga drejtuesi i departamentit, të argumentuara me shkrim, dhe miratohen përfundimisht nga drejtuesi i njësisë kryesore.
 4. Masat disiplinore c) dhe d) të pikës 2 të këtij neni propozohen nga drejtuesi i departamentit, të argumentuara me shkrim, dhe përcillen nga drejtuesi i njësisë kryesore për miratim përfundimtar në Këshillin e Etikës së UV.
 5. Masat disiplinore merren nga organet përkatëse të Universitetit, sipas kompetencave të përcaktuara në Statut, në Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit dhe në Kodin e Etikës.
 6. Vendimet e marra i komunikohen studentit ndërkombëtar në mënyrë zyrtare dhe atij i garantohet e drejta për ankim, sipas procedurave në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

KAPITULLI IX

DIPLOMIMI

Neni 20
Diplomimi

Në përfundim të programit të studimeve, studenti ndërkombëtar ka të drejtë të diplomohet, sipas përcaktimeve të Rregullores së brendshme të UV, me mbrojtjen e tezës së diplomës ose me provim formimi, sipas kërkesave të programit të studimit.

Neni 21

Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementit të diplomës

1. Në përfundim të programit të studimit, studenti ndërkombëtar pajiset me diplomën ose certifikatën përkatëse, të lëshuar nga Universiteti “Ismael Qemali” Vlorë ose edhe një IAL tjetër, në rastin e programeve të dyfishta apo të përbashkëta.
2. Diplomat e lëshuara në përfundim të programeve të ciklit të parë, të ciklit të dytë, si edhe ato të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”, shoqërohen me suplementin e diplomës.
3. Suplementi i diplomës përshkruan, në mënyrë të veçantë, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve të kryera nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Forma dhe specifikat e suplementit përcaktohen në rregulloret e UV-së, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë përgjegjëse për Arsimin.
4. Në rast të humbjes apo dëmtimit të diplomës origjinale, Universiteti “Ismael Qemali” Vlorë nuk lëshon duplikatë diplome, por mund të lëshojë një dokument të barasvlefshëm në formën e vërtetimit, i cili duhet të përmbajë: emrin e Universitetit, numrin e diplomës origjinale, datën e lëshimit të saj, ciklin dhe programin e studimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

KAPITULLI X
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 22
Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit në Senatin Akademik të UV dhe është e detyrueshme për të gjitha palët.
2. Çdo ndryshim apo plotësim në këtë rregullore bëhet me vendim të Senatit Akademik të Universitetit.
3. Për rastet që nuk parashikohen në këtë rregullore, zbatohen aktet ligjore dhe rregullat e tjera të brendshme të universitetit.
4. Kjo rregullore publikohet në gjuhën shqipe dhe angleze në website të UV.

R E K T O R E
Prof.Dr. AURELA SALIAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

SHTOJCAT (Dokumentet Operacionale)

Annex 1 – Formulari i Aplikimit

Annex 2 – Formati i tarifës së shkollimit dhe udhëzimet e pagesës.

Annex 3 – Manuali dhe udhëzuesi i orientimit për studentët ndërkombëtarë.

Annex 4 – Deklarata personale e aplikantit

ANNEX 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

APPLICATION FORM
FOR PROGRAMS OFFERED IN ENGLISH AT THE UNIVERSITY 'ISMAIL
QEMALI' VLORE

Study program: ☐ Bachelor in Architecture Sciences for Heritage
☐ Bachelor in Computer Engineering
☐ Bachelor in English Language

Academic Year: 2025-2026

Section A: Personal Information

